



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Nr. 14-020/01-275630, më 27. 12. 2022

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/15, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010 dhe nenit 37 të Ligjit për Procedurën e përgjithshme administrative nr. 05/L-031, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë :

V E N D I M

1. Miratohet formimi i organit kolegjal këshillëdhënës për shqyrtimin e kushteve urbanistike dhe lejeve ndërtimore.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, organi kolegjal është në këtë përbërje:
 1. Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit;
 2. Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik;
 3. Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës;
 4. Vllaznim Osmani, shef i Kabinetit të Kryetarit;
 5. Ekspert i jashtëm me rotacion.
3. Organi kolegjal këshillëdhënës i cekur si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të mbikëqyret nga Kryetari i Kryeqytetit.
4. Detyrë e organit kolegjal të cekur si në pikën 2 të këtij Vendimi, është shqyrtimi dhe dhënia e komenteve këshillëdhënëse për kushtet urbanistike dhe lejet ndërtimore të blloqeve të cilat tejkalojnë 5000 m² si dhe lagjet e banimit individual të cilat tejkalojnë 20 shtëpi.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 14-020/04-0112470/22 i dt. 20.05.2022.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

U DORËZOHET:

- Organit kolegjal;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

